

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaPlast®-250

SUPERPLASTIFIKATOR ME PERFORMANCË TË LARTË PËR BETONIN



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaPlast®-250 është një superplastifikator i gjeneratës së re & reduktues në shkallë të lartë i ujit tek betoni.

PËRDORIMET

SikaPlast®-250 është një superplastifikator për shumë përdorime, veçanërisht i përshtatshëm për njësitë e prodhimit të betonit të gatshëm. Mundëson reduktim në shkallë të lartë të ujit dhe kontribuon për përfitim të një miksi të përmirësuar betoni. Përdoret për:

- Beton të gatshëm
- Beton me reduktim të lartë të ujit
- Rastet e aplikimeve të betonit me kërkesa të larta
- Rastet e aplikimeve në kantiere që kërkojnë lloje të ndryshme rezistencash betoni për aplikim, duke përdorur mikse dhe lëndë të parë të ndryshme

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

SikaPlast®-250 është një superplastifikator i fuqishëm i bazuar në teknologjinë inovative të polimereve, që ofron avantazhet e mëposhtme:

- Reduktim i lartë i ujit, që rezulton në beton të ngjeshur, rezistenca të larta dhe përshkueshmëri të reduktuar
- Prodhon mikse më pak të ndryshme ndaj diferencimit të agregateve dhe/ose llojeve të ndryshme të çimentos
- Ka performancë të lartë edhe në doza të ulëta

- Ofron plasticitet të lartë, që rezulton në rrjedhshmëri, derdhje dhe kompaktim të përmirësuar
- Tkurrije e reduktuar gjatë trajtimit dhe zvarrje e reduktuar e betonit të ngurtësuar
- Ofron shumë mundësi për optimizimin e kostos së një recepture, si:

1. Përdorim i më shumë se një lloji çimentoje / reduktim çimentoje
2. Recepturë më ekonomike

SikaPlast®-250 nuk përmban jone kloruri dhe si pasojë është i përshtatshëm për betonin e armuar dhe të paranderur.

MIRATIME / STANDARDE

Aditiv reduktues në shkallë të ujit / superplastifikues (Tabelat 3.1 & 3.2) sipas EN 934.02:2009+A1:2012, Deklaratë Performance 42475323 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Solucion ujor i polimereve polikarboksilate të modifikuara
Ambalazhi	IBC, fuçi 220 kg, bidon 20 kg. Furnizim rifuxho me porosi.
Paraqitja / Ngjyra	Lëng, kafe
Jetëgjatësia	8 muaj nga data e prodhimit

Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.
Dendësia	~ 1.11 kg/l (në +20°C)
Vlera e pH	7.0 – 9.0 (në +20°C)
Përmbajtja totale e joneve të klorurit	Nuk ka (EN 934.01)

TË DHËNA TEKNIKE

Udhëzime për betonimin	Duhet të zbatohen rregullat standarde e praktikës së betonimit të mirë, për sa i përket prodhimit dhe hedhjes së betonit. Referohuni tek standardet përkatëse. Duhet të kryhen prova laboratorike përpara adaptimit të miksit në kantier, sidomos në rastet e një recetë të re apo lëndëve të para të reja. Betoni i freskët duhet të trajtohet në mënyrë të përshtatshme.
-------------------------------	--

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar	0.5 – 2.0% për peshë çimentoje
Kompatibiliteti	SikaPlast®-250 mund të kombinohet me produktet e mëposhtme Sika: - seria Sika® Plastiment® - seria Sikament® - Sika® Plastocrete® N/ Sika®-1+/ Sika® WT-200 P - Sika® Ferrogard®-901 S - Sika® Visco I-100 - Sikafume® HR-E / Sikacrete® AR - Sika-Aer® Fine Rekomandohet kryerja e provave përpara kombinimit të produkteve.
Mënyra e aplikimit	SikaPlast®-250 shtohet në ujin e përzierjes në fabrikë ose në betonieren kantierit. Për të përfituar plotësisht nga avantazhet dhe mundësitë që ofron materiali, rekomandohet një kohë përzierjeje prej të paktën 60sek / m ³ , e cila mund të modifikohet në varësi të kushteve të përzierjes dhe betonieres.
Kufizime	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përdorimi i SikaPlast®-250 duhet bërë bazuar mbi një recetë të miratuar dhe duke testuar burimin e materialeve vendase. ▪ SikaPlast®-250 nuk duhet të shtohet në çimento të thatë. ▪ SikaPlast®-250 duhet të shtohet në ujin e përzierjes ose të hidhet në fund të procesit të përzierjes. ▪ Përpara aplikimit duhet të kryhen testime përshtatshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaPlast®-250

Mars 2019, Botimi 01.01

021301011000000797

SikaPlast-250-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf